

Ekskluzive

Ekskluzive | Kapet pas një muaji në arrati i dyshuari për tentim-vrasjen në Miradi – Policia ia gjen edhe armën që dyshohet se u përdor në plagosje



Sinjali.com

15 Gusht 2026 11:28



Pas rreth një muaji në arrati, Policia ka arritur ta lokalizojë dhe arrestojë personin e dyshuar për plagosjen me armë zjarri që ndodhi në korrik në Miradi të Epërme të Fushë Kosovës, rast ky që po hetohet si “Vrasje në tentativë”, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është Fidan Sinani, rreth 45-vjeçar, ndërsa viktimja e rastit është I.Gj., rreth 61-vjeçar.

Ngjarja kishte ndodhur më 15 korrik, rreth orës 20:40, në rrugën “Prizreni” në Miradi të Epërme.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, mes Sinanit dhe I.Gj dyshohet se fillimisht kishte shpërthyer një mosmarrëveshje verbale lidhur me një pronë, e cila më pas kishte eskaluar.

Sinani dyshohet se kishte nxjerrë një pistoletë dhe kishte qëlluar I.Gj, duke e plagosur në këmbën e djathtë.

Viktima ishte dërguar nga familjarët në QKUK, ku ishte konstatuar se kishte plagë hyrëse-dalëse në këmbë. Sipas raportit të atëhershëm mjekësor, gjendja e tij ishte stabile dhe ishte jashtë rrezikut për jetë.

Ndërkohë, i dyshuari ishte larguar nga vendi i ngjarjes me një VW Passat të zi. Vetura ishte gjetur më pas e braktisur në oborrin e vëllait të tij, ndërsa Sinani nuk ishte lokalizuar dhe kishte mbetur në arrati.

Hetimet për gjetjen e tij kanë vazhduar deri më 14 gusht, kur Policia ka siguruar informacione për vendndodhjen e të dyshuarit.

Hetuesit në Prishtinë, të asistuar nga Njësia e Reagimit të Shpejtë dhe Policia e Fushë Kosovës, kanë lokalizuar dhe arrestuar Sinanin.

Gjatë arrestimit, Policia ka gjetur dhe sekuestruar tek ai një armë zjarri, një karikator dhe tre fishekë. Sipas informacioneve të rastit, arma dyshohet se është përdorur në plagosjen e 15 korrikut dhe është sekuestruar për procedurat e mëtejshme hetimore.

Sinani është intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës, ndërsa pas konsultimit me Prokurorinë Themelore në Prishtinë – Departamentin për Krime të Rënda, ndaj tij është lëshuar aktvendim për ndalim prej 48 orësh.

Rasti po hetohet për “Vrasje në tentativë” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera